

VENDIM
Nr.358, datë 12.5.2010

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.984, DATË 30.9.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT, NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR CIKLIN E DYTË TË
STUDIMEVE DHE “MASTER I NIVELIT TË PARË”, ME KOHË TË PLOTË, PËR
VITIN AKADEMIK 2009-2010”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34,35,36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I.Në vendimin nr.984, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat e mëposhtme:

1.Në tabelën nr.3, që i bashkëlidhet vendimit, pas shkronjës “g” shtohet shkronja “gj”, me këtë përmbajtje:

“gj.Në universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër:

i) “Arkeologji dhe administrim të pasurive arkeologjike” 60 000 lekë.”.

2.Në tabelën nr.4, që i bashkëlidhet vendimit, pas shkronjës “g”, shtohet shkronja “gj”, me këtë përmbajtje:

“gj.Në universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër:

i) “Arkeologji dhe administrim të pasurive arkeologjike” 200 000 lekë.”.

II)Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha